




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave



V E N D I M

Nr. 746, datë 24.10.2012

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT TË INSTITUCIONIT
PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË "SHKOLLA E LARTË PRIVATE
"UNIVERSITETI POLIS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5 e 43, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të institucionit privat të arsimit të lartë "Shkolla e lartë private "Universiteti Polis"", nga shkollë e lartë universitare në universitet.
2. Ky institucion privat i arsimit të lartë ruan akreditimin institucional dhe të programeve të studimit, të fituar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në këtë institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

SALI BERISHA

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

MYQEREM TAJAJ

NR.PROT.3318/1
DATË 7.11.2012

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË FINANCAVE
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE



100 Vjet Pavarësi

Gjergj LEZHJA

Sekretar i Përgjithshëm

